

STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE

“Golden Baker Shpk”

Sot me date 24/01/2023 Mbështetur ne Kushtetutën dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikës se Shqipërisë, ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prona private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi nga ortaku i vetem :

Z. Aleksandro Vasho lindur me date 05/11/1998 ne Greqi, banuese ne Gjirokaster, mbajtes i kartes se identitetit me nr. ID J81105064G, vendosi te krijoje shoqerine tregtare me perjegjesi te kufizuar “Golden Baker “ me akt themelimi si vijon :

NENI 1

FORMULIMI

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur “Golden Baker “. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise “Golden Baker “ do te kete seline ne rrugen “Bulevardi 18 Shtatori”, Gjirokaster 6002. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikës se Shqipërisë , vetem me vendim te asamblese se ortakeve.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e tregtise duke importuar produkte te ngrira per t'u treguar me pas ne tregun vendas. Sherbimi do te kryhet ne perputhje me cdo ligj te zbatueshem dhe rregullore.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfarëdo lloj shkaku .

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestari i shoqerise private “Golden Baker “ është 100.000 LEKE (Njeqind mijë leke) i ndarë në një 1 kuotë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë nga ortaku i vetem Z. Aleksandro Vasho , qe zotëron 100 % (Njeqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë . Kapitali themeltar fillestari mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestari).

Në rast se një ortak apo një bashkëzotëruesh i një kuote humb jetën, trashegimtaret e tij do te janë të vetmit persona që do ti njihet titulli mbi kuoten nga Shoqeria; por asnjë nga keto parashikime nuk çiron perjegjesite e trashegimtareve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Ne rastin e vazhdimit te Shoqerise me disa trashegimtare te ortakut qe ka humbur jeten, trashegimtaret duhet te caktojne një perfaqesues te perbashket. Personi qe fiton te drejten mbi një kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkonte regjistrimin e kuotes ne emer te një personi tjeter te caktuar prej tij si perfittues i kuotes. Nese personi i mesiperm zgjedhe te behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese personi i mesiperm zgjedh te kerkonte regjistrimin e kuotes ne emer te një personi tjeter atehere ai duhet ta kryeje ate nepermjet një akti te vlefshem te transferimit te kuotes. Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te një ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoreturesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria administrohet nga një administrator qe zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme per një periudhe 5 vjeçare. Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet ne çdo kohë nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise, pervec atyre qe ligji ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se per gjithshme apo organeve te tjera te shoqerise,

Administratori vepron ne perputhje me politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori eshte perjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e Shoqerise. Administratori mund

te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve, akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise duke mbajtur perjegjesi per te gjitha veprimet e kryera nga te tretet e deleguar per administrimin e shoqerise. Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te shoqerise. Ne rast konflikt interesit, administratori do te njoftojte menjehere ortaket si dhe do te heq dore nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

Administrator i shoqerise do te jetë Z.Aleksandro Vasho, shtetas shqiptar, i lindur ne Greqi me date 05/11/1998 mbajtes I kartes se identitetit nr. Id J81105064G me nje afat te percaktuar 5 vjecar.

NENI 7

BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI

Viti Financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori I paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise si dhe llogarite vjetore.

Pasi te jene perm bushur kerkesat e percaktuara nga Ligji "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Shoqeria me vendim te Asamblese se Pergjithshme vendos shperndarjen e dividentit ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

NENI 8

PRISHJA DHE LIKUDIMI I SHOQERISE

Ne rastin e prishjes dhe likujdimit te shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miquesisht mes paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne ne nje zgjidhje te perbashket atehere do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatene Rethit Gjyqesor Tirane .

NENI 10

VULA

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

LIGJI ZBATUESHEM

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

Akti I themelimit u perpilua ne 3 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe 2 kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "Golden Baker ". Akti I themelimit nenshkruehet rregullisht nga ortaket.

ORTAKU VETEM

ALEKSANDRO VASHO

